



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



REPUBLIKA E KOSOVËS
RI PUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	09.02.16	Vendi	KAÇANIK
	Nr. org.		Numri	Shtojcë
		01-16-5998	7	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

RAPORTI I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2015

Kaçanik, Shkurt 2016

Vështrim hyrës

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015, i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare, të arriturat e Komunës dhe njëkohësisht vështirësitë me të cilat jemi përball gjatë vitit 2015.

Jam munduar të zbatojë aktivitetet që janë të përcaktuara me Statut të Komunës dhe zbatimin e përgjegjësi si kryetar i Komunës duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj, jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme, rininë etj. Një bashkëpunim të sinqertë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet dhe debatet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, ndërsa janë trajtuar tema të ndryshme me theks të veçantë Buxheti i Komunës për vitin 2016, ndërkohë që janë mbajtur dy dëgjime buxhetore dhe dy debate të rregullta me qytetarë.

Unë jam i kënaqur që kemi arritur të vazhdojmë me investime në infrastrukturën rrugore, rrjete kanalizimesh, ujësjellës por edhe vazhdimin e ndërtimit të shtretërve të dy lumenjve: Lumit Lepenc e Nerodime, palestrës sportive, stadiumit të futbollit, ndërtimin e QKRC-së dhe QKRA-së e sidomos ndërtimin e objektit të QKMF-së, për të cilin objekt do të financohet shuma prej 1,245,000 euro prej të cilave Komuna ka ndarë 350,000 euro, Ministria e Shëndetësisë 650,000 euro, Caritasi 200,000 euro dhe ambasada e Luksemburgut ka participuar me 45,000 euro, ndërsa pritet së shpejti të funksionalizohet.

Janë asfaltuar afër 10,259 kilometra rrugë të reja, 11 kilometra rrjete kanalizimesh dhe janë shtruar 3580.60 m² sipërfaqe me kubëza betoni, ndërsa është ndërtuar edhe trotuarit për këmbësor në fshatin Begracë dhe një pjesë e rrugës hyrëse në qytetin e Kaçanikut nga magjistralja M2-drejtimi Shkupit, me gjatësi të përgjithshme prej 1560 metra.

Investime të rëndësishme janë bërë në ujësjellës, ndërsa duhet veçuar projektin “Sanimi, rekonstruimi dhe rritja e kapaciteteve ujore për fshatrat Dubravë, Rekë, Doganaj, Soponicë, Elezaj, Koxhaj, Nikaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër”, projekt dy vjeçar që ka nis të realizohet vitin e kaluar, për të cilin projekt do të financohet shuma 948,000 euro, ndërsa financohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Komunën dhe komunitetet e sipërpërmendura.

Po ashtu, nuk kanë munguar edhe investimet në hapësirat e gjelbëruara, ndërkohë që vitin e kaluar janë gjelbëruar edhe 6900 m², hapësira publike në qytetin e Kaçanikut, dhe janë mbjellës afër 300 fidane drunjëve dekorativ në këto hapësira.

Në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, në objektin e shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik është bërë rehabilitimi i fasadës dhe ndërtimin e kulmit.

Vitin e kaluar ka përfunduar edhe projekti për rekonstruimin e kadastrit në 5 zona kadastrale në Komunën tonë: Kaçanik, Kaçanik i Vjetër, Bob, Runjevë dhe Begracë.

Po ashtu është bërë edhe vendosja e tabelave me emërtimet e rrugëve në territorin e Komunës së Kaçanikut, i cili si proces është në fazën e fundit, respektivisht shqyrtimit të disa ankesave lidhur me emërtimet në disa vendbanime.

Edhe këtë vit kanë vazhduar investimet në fushën e trashëgimisë kulturore, si një thesar shumë i çmuar i Komunës sonë, ndërsa duhet veçuar investimet në kalanë e qytetit përmes projektit “Konservimin dhe revitalizimin e pjesshëm në kalanë e qytetit”, renovimin e shtëpisë së dëshmorit Ismal Raka dhe fillimin e rindërtimit të objektit historik të quajtur Kulla e Hasanit, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë më të re kulturore. Në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Mbrojtjen e Natyrës është marrë vendimi nga

Kuvendi Komunës, për futjen nën mbrojtje edhe të 14 rasteve të vlerave natyrore të karakterit botanik, speleologjik dhe gjeomorfologjik, në disa pjesë të komunës tonë. Kanë vazhduar investimet në kompleksin memorial të dëshmorëve dhe janë rregulluar edhe varrezat e veteraneve të luftës së UÇK-së, dhe lokacioni ku janë të vendosura edhe varrezat e dëshmorëve si dhe bustet e tre dëshmorëve në ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Nuk kanë munguar investimet në lëmin e bujqësisë ndërsa fermerët janë mbështetur edhe në sektorët e lavërtarisë, perimekulturë e pemëtari, përderisa kemi vazhduar me ofrimin e shërbimeve të mira shëndetësore dhe furnizim konstant me barna esenciale. Ndërkohë, duke e konsideruar arsimin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror, janë bërë investime në renovimin e objekteve shkollore, mirëmbajtjen e tyre dhe është vazhduar me trajnime profesionale me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe arritjen e standardeve më të avancuara.

Komuna e Kaçanikut e ka shpenzuar 97,72 % të buxhetit për vitin 2015, në shumë prej 6,942,159 euro, nga 7,103,839 euro të alokuara apo për 0,51 % më shumë se një vit më parë (97,21%). Duhet theksuar se granti qeveritar është shpenzuar 99,71% apo 6,363,848 euro nga gjithsej 6,382,764 euro të alokuara, ndërsa të hyrat vetjake komunale janë realizuar në shkallë prej 80 % apo 556,372 euro nga 695,757 euro të planifikuara apo për 4,26 % më shumë se një vit më parë. Sipas kategorive ekonomike, për paga janë shpenzuar 4,711,887 euro, për mallra dhe shpenzime 453,386 euro, për shërbime komunale 123,889 euro, për subvencione dhe transfere 266,721 euro dhe për investime kapitale 1,386.273 euro.

Prioritetet kryesore për Kaçanikun vazhdojnë të jenë:

- Ushtrimi i përgjegjësisë dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e punës
- Mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës dhe zbatimin e planeve investuese të komunës, përkatësisht investimet substanciale në infrastrukturë fizike duke përfshirë rrugët, ujin e pijshëm dhe kanalizimet.
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies së qytetarëve.
- Krijimi i kushteve të volitshme për investime të drejtpërdrejta, shtimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimit ekonomik.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe ngritja e cilësisë në arsim
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje
- Hartimi i hartave zonale
- Ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës, administratën e saj dhe zbatimin e akteve të Kuvendit të Komunës.
- Bashkëpunim ndërkomunal, nivelet qendrore, Asociacionin e Komunave të Kosovës Organizatat ndërkombëtare etj.

Komuna e Kaçanikut prioritetet Strategjike gjatë vitit 2015 kishte:

- Ofrimi i shërbimeve të shpejta e cilësore
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike, me theks të veçantë në rrugë, rrjete ujësjellësish dhe kanalizime.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes ngritjes së kapaciteteve teknike dhe njerëzore.
- Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë

- Promovimi i trashëgimisë kulturore
- Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës dhe mbrojtja e pyjeve
- Përmirësimi i aktiviteteve rinore

Shërbimet janë ofruar përmes drejtorive dhe zyrave si në vijim:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

Çfarë kemi arritur

Tabela në vijim përmbledhë aktivitetet dhe arritjet kryesore gjatë vitit 2015. Më shumë hollësi janë dhënë në Shtojcën e bashkëngjitur në këtë raport, në të cilën jepen informata lidhur me performancën e secilës drejtori/program.

Priotiteti 1: Ofrimi i shërbimeve të shpejta e cilësore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet / progresi / performanca kyçe gjatë vitit 2015
- Kryerja e të gjitha shërbimeve për qytetarë në një vend që ka mundësuar shërbime të shpejta e cilësore	Janë realizuar 99,94 % e kërkesave, përkatësisht janë protokolluar dhe lëshuar 44458 dokumente

1	Departamenti	Në pritje për pranim	Të pa shqyrtuara	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Totali
2	01. Shërbimi i Kryetarit	0	6	6	1151	120	0	5	1301
3	02. DAP	0	0	7	27251	10	48	5	27323
4	03. DSHMS	0	4	24	222	61	1	1	312
5	04. DAK	0	4	3	456	291	0	0	754
6	05. DEFZH	0	0	0	5258	8	9	1	5275
7	06. DUKMM	0	3	58	7893	57	4	1	8016
8	07. DESHP	0	0	24	250	57	0	9	331
9	08. DBZHP	0	2	1	1109	33	0	1	1146
	Gjithsejtë	0	26	132	43590	637	62	11	44458

Prioriteti 2: Procesi i trajtimeve të ndërtimeve pa leje	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Regjistrimi i objekteve të pa Leje pa leje dhe futja në Regjistrin shtetëror të ndërtimeve pa Leje i cili është publikuar në faqet e MMPH. Fushata e zhvilluar në bashkëpunim me MMPH, për sensibilizimin e këtij procesi në teren dhe fillimi i procesit të aplikimit për marrjen e lejes së legalizimit i cili zgjat deri më 16.03.2016.	Janë identifikuar afër 8679 objekte pa leje dhe janë futur në sistem të dhënat. Kemi 13 raste të aplikimit dhe janë lëshuar 2 Leje për legalizim. Në vitin 2015 janë lëshuar 49 Leje Ndërtimi.

Prioriteti 3: Ofrimi i shërbime publike dhe krijimi i infrastrukturës me theks të veçantë në rrugë, rrjete ujësjellësish dhe kanalizime	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	Janë asfaltuar afër 10.259 km rrugë, 11 km kanalizime, afër 3580.60 m ² rrugica me kubëza betoni, totuar për këmbësor 1560 m ² , dhe investime në mirëmbajtjet dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit.
Mirëmbajtja e ndriçimit publik	Rrugët e qytetit në vazhdimësi kanë qenë të ndriçuara nga ndriçimi publik.

Prioriteti 4: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Asfaltimi i rrugëve lokale	Është arritur të asfaltohen rrugë në gjatësi 10.259 km dhe të shtrohen me kubëza betoni rreth 3580.60 m ² rrugica, rehabilitimi i pjesëve të dëmtuara të asfaltit në qytet dhe zona rurale. Ndërtimi i trotuarit për këmbësor në fshatin Begracë dhe një pjesë të rrugës në hyrjen e qytetit të Kaçanikut, nga magjistralla M2-drejtimi Shkupit. Është përmirësuar dukshëm qarkullimi i njerëzve dhe automjeteve.

Prioriteti 5: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes përmbushjes së nevojave për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore	
Mbulimi me mjekë i QKMF-së dhe AMF-ve	Në QKMF është bërë mbulimi me Mjekë dhe staf tjetër: dy mjekë, një laborant dhe një vozitës.
Përmirësimi i kushteve të punës në QKMF dhe QPS	Është ndërtuar objekti i ri i QKMF-së, ndërsa sivjet janë duke u bërë punët finale për funksionalizimin e tij. Janë ndërtuar dy anekse, në QMF në Bob dhe QMF-në Doganaj. Janë ndërtuar rrethoja në QMF-në e Bobit, është rregulluar kanalizimi dhe ujësjellësi

	në AMF-në e Stagovës Në QPS janë rinovuar nyjet sanitare dhe është shtruar dyshemeja në ambientet e QPS-së.
Aplikimi i mjekësisë familjare në QKMF, QMF dhe AMF	- Ka vazhduar implementimi i mjekësisë familjare sipas standardeve në të gjitha qendrat mjekësore familjare

Shërbimet Shëndetësorë

Gjatë vitit 2015 është bërë riorganizimi i brendshëm i QKMF-se , ku është ngrit cilësia e shërbimeve shëndetësore primare dhe implementimi i mjekësisë familjare në QKMF-e, QMF-e dhe AMF-të ekzistuese.

Furnizimi me barna nga lista esenciale është përmirësua dukshëm krahasuar me vitin paraprak, ndërkohë që ka filluar ofrimi i shërbimeve shëndetësore primare për herë të parë me tri ndërrime me çka është ngrit cilësia e shërbimeve dhe është ulë ngarkesa e punës për stafin shëndetësor.

Shërbimet shëndetësorë në Komunën e Kaçanikut janë monitoruar edhe nga ekipet e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa nuk ka pasur ndonjë vërejtje.

Shërbimi Social

Gjatë vitit 2015 janë dërguar në komision mjekësor 600 kërkesa ku prej tyre 553 pozitiv 47 janë refuzuar .

Ekipi i shërbimeve sociale ka trajtuar të gjitha rastet e ofruara që janë kompetencë e këtij sektori .

Me ligjin e ri për përkrahjen e familjeve të fëmijëve me nevoja të veçanta gjatë këtij viti të drejtën për ndihmë financiare e kanë realizuar 63 cilat i marrin 100 € për çdo muaj, prej tyre 5 janë të verbër që marrin nga 200 € për çdo muaj .

Nga evidenca që është mbajtur rregullisht nga ekipi i asistencës sociale shfrytëzuesit e ndihmave sociale, mesatarja mujore ka qenë 850 familje që shfrytëzojnë ndihmat sociale Gjatë këtij viti është sanuar problem i nyjeve sanitare për të cilat Inspektorët e AUV të Kosovës (inspektorët sanitar) kanë dhënë rekomandimet gjatë vizitës së bërë nga ky inspektion.

Shërbimi i Inspekcionit

Inspektori Sanitar ka marrë këto masat dhe ka ushtruar mbikëqyrjen sanitare ndaj : prodhimit, përpunimit, ruajtjes dhe distribuimit të artikujve ushqimor, përmbushjen e kushtet higjieno – sanitare të objekteve, gjendjen shëndetësore të personave të cilët punojnë në punët me të cilat mundë të rrezikojnë shëndetin e popullatës, mbrojtjen e shëndetit nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, dhe pirjes së duhanit në vendet publike, ujit, objekteve stabilimenteve dhe aparateve për furnizim me ujë të pijshëm, objektet parashkollore, shkollore, objekteve të higjienës personale, objekteve publike, me një qëllim të mbrojtjen se shëndetit të popullatës.

Prioriteti 6: Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë

Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2015

Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i njohurive të nxënësve	<ul style="list-style-type: none">- Është mbajtur provimi i maturës në dy afatet; në atë të qershorit (pjesa e parë dhe e dytë) dhe gushtit (pjesa e parë dhe e dytë), ndërsa kalueshmëria ka qene rreth 77,5 %- Është organizuar dhe mbajtur me sukses edhe Testi i arritshmërisë për klasat IX, për rreth 660 semimaturant dhe mesatarja e kalueshmërisë ka qenë rreth 55 %.- Gjatë vitit 2015 është organizuar dhe mbajtur Testi Ndërkombëtar PISA. Të përzgjedhur kanë qenë nxënës nga 5 shkolla: "Jusuf Gërvalla" "Emin Duraku: dhe "Gafurr Luma" dhe dy shkollat e mesme: Gjimnazin "Skënderbeu" dhe ShMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka", ndërsa testit iu kanë nënshtruar 100 nxënës të përzgjedhur nga PISA. Rezultatet do të publikohen gjatë vitit 2016.
Organizimi i trajnimeve profesionale	Gjatë vitit 2015, kanë vazhduar trajnimet e mësimdhënësve, në bashkëpunim me MASHT-in dhe GIZ-in, në fusha të ndryshme.
Zhvillimi i aktiviteteve jashtëmësimore	Mbajtja e garave të diturisë në nivele të ndryshme: Olimpiada e Matematikës së Kosovës; Gjuhëtari i Ri 2015; garat në nivel komunal në 7 lëndë mësimore,

	<p>Universiada 2015, garat e kimisë dhe gjuhës angleze në kolegjin "Mehmet Akif" etj.</p> <p>Nxënës pjesëmarrës kanë treguar rezultatet të kënaqshme.</p>
Investimet në objektet shkollore	<p>Çerdhja "Agimi", Kaçanik - Ndërrimi i dritareve,</p> <p>Gjimnazi "Skënderbeu", Kaçanik - Lyerja e Objektit dhe sanimi i mureve të brendshme</p> <p>Shkolla Fillore "Ali Asllani", Doganaj - Renovimi i rrethojës së oborrit dhe tualeteve</p> <p>Shkolla Fillore "Dituria", Shtrazë - Riparimi i kulmit</p> <p>Shkolla Fillore "Dituria", Ivajë - Ndarja e klasave</p> <p>Shkolla Fillore "Qamil Ilazi", Kaçanik i Vjetër - Riparimi i tualeteve</p> <p>Shkolla Fillore "Idriz Seferi", Kovaçec - Ndërrimi i gypit të ujës/jellës</p> <p>Shtëpia e Kulturës - Renovimi i tualeteve</p> <p>Shkolla Fillore "Nazmi Osmani", Elezaj - Riparimi i kulmit</p> <p>Ndërtimi i aneksit të objektit të shkollës fillore "Ali Asllani"</p> <p>Rehabilitimi i kulmit dhe tavanit të shkollës fillore "Nazmi Osmani"</p>
Rikualifikimi, organizimi dhe sistemimi i mësimdhënësve.	<p>Mbi 50 mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike janë rikualifikuar në nivelin Baçelor, dhe është bërë harmonizimi i pagave të tyre .</p> <p>Janë pajisur me kontrata të pa afatshme mësimdhënësit të cilët kanë mbi 10 orë dhe përgatitje adekuate sipas Udhëzimeve të MASHT-it.</p>
Krijimi i kushteve më të mira për punë	<p>Pagesa e transportit të nxënësve në shkallë 50 % për nxënës me kushte jo të mirë ekonomike</p> <p>Afër 50 bursa nga Fondacioni Kosovë-Luksemburg e shoqata tjera</p> <p>Mbështetja e të gjitha shkollave me projekte nga Fondacioni Kosovë-Luksemburg. Secila shkollë ka përfituar mjete shkollore në vlerë 2 mijë euro.</p>

Prioriteti 7: Promovimi i trashëgimisë kulturore

Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/perforanca kyçe gjatë vitit 2015
Zbatimi i Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore-PLTK	Është përmbyllur projekti i mbështetur nga CHwB-ja dhe Komuna e Kaçanikut, ndërsa është realizuar konservimi dhe revitalizimi i kalasë së qytetit, meremetimi i shtëpisë së dëshmorit Ismail Raka dhe ka filluar rindërtimi i objektit historik të quajtur Kulla e Hasanit, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë më të re kulturore

Prioriteti 8: Përmirësimi i aktivitetet rinore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/perforanca kyçe gjatë vitit 20145
Shënimi i datave të rëndësishme për rininë	Me mjete financiare janë mbështetur aktivitetet rinore duke i përfshirë një varg aktiviteteve sportive e aktivitetet tjera nga fusha të ndryshme. Njëkohësisht, është arritur të bëhet masivizimi dhe ngritja në nivel më të lartë i aktiviteteve rinore - sportive
Organizimi i aktiviteteve kulturore	Përmes organizimit të Festivalit XXVII me radhë është arritur të ruhen vlerat kulturore Është ruajtur tradita e këngëve dhe valleve popullore që kultivohen në trojet shqiptare
Organizimi i aktiviteteve sportive	Identifikimi i talenteve për aktivitetet sportive Janë mbajtur turne në fusha të ndryshme sportive që kanë promovuar talent të rinj.

Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës, rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve

Aktivitete kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2015
<p>Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga qytetarët Mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti Komunës</p>	<p>Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës, nga projektet e realizuara kanë përfituruar 743 fermerë:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Nga projekti për mbështetje të fermerëve me repromaterial bujqësor (farë misri, dhe pleh mineral), kanë përfituruar 320 fermerë, vlera e projektit 12,800.00 € * Projekti për mbështetje të fermerëve me serra, vlera projektit 28,308.50€, përfitues 55 fermerë.(projekt me participim të fermerëve) * Projekti për mbështetje të fermerëve me repromaterial bujqësor (farë gruri, dhe pleh mineral), kanë përfituruar 336 fermerë, vlera e projektit 18,482.70 €. *Projekti për mbështetje të fermerëve me fidanë të mjedrës, vlera projektit 11,000.00€, përfitues 20 fermerë (projekt me participim të fermerëve). <p>Projekti për panairin e gjedhit “Kaçaniku 2015”, (12 fermerë kanë përfituruar shpërblime në vlerë prej 100-250 €), vlera projektit 2,450.00€,</p> <p>* Këtë vit kemi realizuar edhe projektin për rregullimin e kanalit të ujitjes prej Lagjes Lekaj- lagjen Provoli në gjatësi afër 1700 m, vlera e projektit 35,641.00€.</p> <p>Përmes realizimit të këtij projekti, fermerët tani kanë kushte më të mira për ujitjen e kulturave bujqësore, shfrytëzim më racional të ujit si dhe zvogëlim të punës së krahut lidhur me rregullimin dhe pastrimin e kanalit të ujitjes.</p> <p>Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në vlerë prej 6,656.25 €</p>
<p>Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale</p>	<p>Fermerët kanë përfituruar njohuri teorike dhe praktike për kultivimin dhe ruajtjen e kulturave bujqësore nga sëmundjet dhe dëmtuesit</p>
<p>Trajtimi i qenve endacak</p>	<p>Zvogëlimi i rrezikut për nxënësit e shkollave nga kafshimi i qenve endacak, qentë endacak kanë paraqitur rrezik serioz, sidomos për fëmijët. Vlera e projektit 5.994 €</p>

<p>Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ-ët</p>	<p>Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e BZHRP-së ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore.</p> <p>Bashkëpunimi me MBPZHR-së ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, kafshë të imëta (dele, dhi), bletë, projektet për subvencionimin e mbjelljeve pranverore, vjeshtore, subvencionimin e kulturave perimore, pemëtare dhe në projekte për aplikim në grante. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet dhe grantet që ka ofruar MBPZHR. Të gjitha aplikacionet e fermerëve për subvencione janë pranuar në zyrën e DBZHRP-së, të cilat të kompletuara janë dorëzuar në MBPZHR.</p> <p>Nga projektet e MBPZHR për subvencionim dhe grante, në komunën tonë kanë përfituar 511 fermerë. Nga subvencionimi për lopë qumështore kanë përfituar 198 fermerë, me gjithsej 1655 krerë, që kanë përfituar 115,850 €, nga subvencionimi i deleve dhe dhive kanë përfituar 25 fermerë me 3121 krerë dele dhe dhi, kanë përfituar 46,815.00€, në sektorin e bletarisë kanë përfituar 40 bletarë për 1961 koshere me shoqëri bletësh kanë përfituar 19,610.00 €. Për subvencionim të mbjelljeve vjeshtore (grurit) kanë përfituar 109 fermerë për 405.39 ha sipërfaqe të mbjellura, kanë përfituar 60,808.50€, për subvencionim të mbjelljeve pranverore kanë përfituar 102 fermerë për 247.91 ha sipërfaqe të mbjellura, kanë përfituar 37,186.50€. Në sektorin e pemëtarisë janë subvencionuar 26 fermerë për 26,06 ha sipërfaqe, 10.416.00 €, për kultivimin e perimeve në fushë të hapur kanë përfituar 7 fermerë për 5.77 ha sipërfaqe, 1,731.00 €. Marrë në tërësi nga subvencionet e MBPZHR fermerët nga komuna jonë kanë përfituar në shumë prej 292.417 € ndërsa në projektet e granteve kanë përfituar 4 fermerë në vlerë të përgjithshme prej 89,082.52 €, që në total kapë shumën prej 381,499.52€</p> <p>Bashkëpunimi me OJQ-ët ka qenë në mbështetje të tyre për implementimin e projekteve me bashkëfinancim. Nga projektet e bashkëfinancimit janë mbështetur 78 gra fermerë të fshatrave: Dubravë, Nikaj, Biçec dhe Kaçanik i Vjetër, sistemin e ujitjes pikë-pikë, për kultivimin e mjedrës, fasules dhe dredhëzës së malit, vlera e projektit 6,080.00€. Gjithashtu nga projekti i bashkëfinancimit kemi mbështetur shoqatën IKC, me një shumë të mjeteve prej 9,000.00€ për furnizim të 30 fermerëve me fidanë të mjedrës për mbjellje të sipërfaqeve nga 0.10 ha (fshati Begracë 14 gra fermerë dhe në fshatrat Kaçanik i Vjetër dhe Gabrricë 3 fermerë.</p>

<p>Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale [përmes shtimit të masave të veprimit në teren</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes bashkëpunimit me APK-ën , Policinë e Kosovës, rojet e pyllit dhe stafit të pylltarisë, është rritur ndikimi në pengimin e dëmtimit të prerjes dhe transportit ilegal të masës drusore. - Janë konfiskuar 192.74 m³ ose shprehur në metër hapësinore (mh) 275.62, prej tyre shkollave iu janë shpërndarë (115.65 m³ , shprehur në mh 164.22), ndërsa sasia tjetër e masës drusore prej 40%, sipas marrëveshjes i kanë mbetur në shfrytëzim Shoqatës së Invalidëve të Luftës. - Janë ngritur 242 fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje 217 dhe 25 për vepër penale.
<p>Organizimi i takimeve me kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor, Kryetarin e Gjykatës, Prokurorinë si dhe takimeve të rregullta javore me stafin e sektorit të pylltarisë me qëllim informimit për gjendjen e pyjeve dhe aktivitetet që duhet ndërmarr për rritjen e efikasitetit dhe të punës në mbrojtjen e pyjeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rrija e bashkëpunimit dhe mbajta në kontroll e gjendjes së pyjeve përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta Komunë, Polici , Gjykatë dhe roje të pyllit, për të ndikuar në rritjen e efikasitetit të punës, parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve si dhe ofrim më të mirë të shërbimeve për qytetarë
<p>Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore të dhëna me tender dhe shitjen e masës drusore për furnizim të qytetarëve me dru djegës dhe mbeturina</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menagjuës , zgjedhja e operatorit ekonomik i cili i plotësuar kushtet sipas procedurave të prokurimit. Shitja me pakicë e masës drusore të lejuar për furnizim të qytetarëve me dru djegës për vitin 2015. <p>Nga shitja e masës drusore me tender janë realizuar mjete në shumë prej 10,429.65.00 €, nga shitja me pakicë për furnizim të qytetarëve janë realizuar mjete 6,947.50€.</p>
<p>Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar 13,119.51 €, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Ecuritë financiare

Investimet kapitale të financuara nga buxheti komunal për vitin 2015 = 1,366,221.00€
2015: Shuma e mjeteve të shpenzuara ka të bëjë me:

1. Shuma e mjeteve te shpenzuara për ndërtim, asfaltim, shtrimi i trotuareve: 849,000.00€
2. Shuma totale e mjeteve te shpenzuara për ndërtimin e kanalizimeve: 95,540.00 €
3. Zhvillimi i projekteve zhvillimore ne bujqësi: 35,516.00 €
4. Rregullimi, përmirësimi i infrastrukturës ne Arsim, Rini, Sport: 211,692.00 €
5. Ndërtimi i infrastrukturës ne objektet shëndetësore: 155,000.00 €
6. Renovimi i objekteve te Administratës Komunale: 19,473.00 €

Asfaltimi i rrugëve:

Totali i kilometrave te shtruara me asfalt gjatë vitit 2015:

1. Asfaltimi i rrugës Shefeket Fera: L = 305 m gjatësi ,
2. Asfaltimi i rrugës në fshatin Semajë: L = 730 m gjatësi,
3. Asfaltimi i rrugës në Lagjet Mezrajë dhe Tron, ne fshatin Kovaqec: L = 435 m gjatësi,
4. Asfaltimi i rrugëve ne lagjet e K. Vjeter: L = 1345m gjatësi,
5. Asfaltimi i rrugës ne lagjen e Burrnikeve – Runjeve: L = 155 m gjatësi,
6. Asfaltimi i rrugës në Fsh.Gërlicë-Lagja Hasaj: L = 610 m gjatësi,
7. Asfaltimi i rrugëve të lagjeve Mem dhe Bafti: L = 850 m gjatësi,
8. Asfaltimi i rrugës në Lagjen "Ramadan Agushi": L = 200 m gjatësi,
9. Asfaltimi i rrugës nga Stacioni i trenit deri në lagjen Dashi-Stagovë: L = 701 m
10. Asfaltimi i rrugicave në fshatin Gllaboçicë: L = 1270 m gjatësi,
11. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale: L = 810 m gjatësi,
12. Zgjerimi - asfaltimi i rrugës të fshatit Nikë: L = 200 m gjatësi
13. Ndërtimi i mureve mbajtëse ne rrugët: Avdurrahim Shehu, rrugën e fshatit Kotlinë dhe lagjen Koraqi Kovaqec: L = 75 m gjatësi.

Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve:

1. Përgatitja e bazës për asfaltim i rrugës në Lagjen Fazliu, në fshatin Bajnicë L=1800 m
2. Shtrimi me kubeza i rrugës në Lagjen "Ramadan Agushi": L = 200 m
3. Ndërtimi i trotuarit në fsh.Begracë: L = 1481m gjatësi,
4. Shtrimi me kubeza i rrugëve lokale: L = 785 m gjatësi,
 - Totali i kilometrave te shtruara me trotuare , kubeza betoni: L = 4,266m gjatësi

Investimet kapitale të financuara nga Ministritë gjatë vitit 2015

Ministria e Shëndetësisë : Bashkëfinancimi në ndërtimin e objektit të QKMF, Kaçanik, shuma 400,000 euro

Ministria e Administrimit me Pushtetin Lokal: bashkëfinancim në ndërtimin e rrugës Kaçanik i Vjetër, 70,000 euro

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: Ndërtimi i shkollës fillore në Kaçanik, 191,635 euro

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit & QJR : Ndërtimi i Palestrës Sportive, Kaçanik, 311,594 euro

Ministria e Zhvillimit Ekonomik : Shkolla Fillore “Idriz Seferi” Bob

38,818 euro

Ministria e Planifikimit Hapësinor: Rehabilitimi i rrugës në fshatin Shtrazë

4,400 euro

Ministria e Planifikimit Hapësinor: Rregullimi i shtratit të Lumit Lepenc

95,993 euro

Ministria e Planifikimit Hapësinor: Rregullimi i ujësjellësit për nëntë fshatra

142,205 euro

Ministria e Punëve të Brendshme: Automjetet zjarifikës me pajime komplet

145,751 euro

Shpërndarja e buxhetit sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve Krahasimi 2015 me 2014

Tab.3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik							
KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)	Buxheti 2015 (Aktual & Rishikuar)	Shpenzimet e realizuara 31-12-2015	Shpenzimet e realizuara 31-12-2014	Progresi përball plan. Buxhetor (%)	Diferenca Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2015 / 2014 në (€)	Krahasimi 09-2015/ 2014 ne %
	1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1 Pagat dhe medijtjet	4,711,887	4,711,887	4,315,980	100.00	(0)	395,907	109.17
2 Mallrat dhe shërbimet	475,727	453,387	488,117	95.30	22,340	(34,730)	92.88
3 Shpenzimet komunale	139,000	123,890	118,209	89.13	15,110	5,681	104.81
4 Subvencionet dhe transferet	267,322	266,721	169,357	99.78	601	97,364	157.49
5 Shpenzimet kapitale	1,651,973	1,386,274	1,454,299	83.92	265,699	(68,025)	95.32
TOTALI (1 deri 5)	7,245,909	6,942,159	6,545,962	95.81	303,750	396,197	106.05

Të tjera

- Janë kontrolluar të gjitha pagesave sipas përshkrimit të vendit të punës
- Në kategorinë e **Mallrave dhe shërbimeve** janë kontrolluar dhe certifikuar **1,211 lëndë** të cilat kapin shumën prej **453,170.20 €**.
- Në kategorinë e **Shërbimeve Komunale** janë kontrolluar dhe certifikuar **1,196 lëndë** të cilat kapin shumë prej **123,889.89 €**
- Në kategorinë e **Subvencioneve & Transferëve** janë kontrolluar dhe certifikuar **506 lëndë** të cilat kapin shumë prej **266,721.47 €**
- Në kategorinë e **Investimeve Kapitale** janë kontrolluar dhe certifikuar **139 lëndë** të cilat kapin shumë prej **1,386,273.67 €**.
- Raportimi çdo mujor për faturat e papaguara për vitin 2015.
- Përgatitje të shkresave të ndryshme për dezotimin e mjeteve, anulimin e shpenzimeve, anulimin e urdhëblerjeve etj.

Gjithësej 3,052 pagesa të të gjitha kategorive të shpenzimeve të cilat janë certifikuar dhe të cilat kapin shumë prej **2,230,055.23 €**.

Tatimi në Pronë

Gjatë vitit 2015 Zyra e tatimit në pronë ka shpërndarë 8814 fatura në vlerë 274.969,07 € Duke filluar nga 05.01.2015 - 31.12.2015 janë inkasuar 218.179,34 €, ose 82,07%, e shumës së planifikuar prej 265.850,00 €.

Numri i ankesave për tatim në pronë gjatë vitit 2015 është 101, prej tyre janë aprovuar 88, ndërsa janë refuzuar 13.

Zyra e tatimit në pronë ka regjistruar prona të reja dhe janë rianketuar prona ekzistuese.

Vlen te theksohet se me aprovimin e Ligjit mbi faljen e borxheve ZTP ka publikuar listat e tatimpaguesve qe përfitojnë nga Ligji për faljen e borxheve Publike 05/L-043 ,si dhe ka filluar aplikimin e amnesties.

Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve

Numri i bizneseve te regjistruara në qendrën Komunale për regjistrimin e bizneseve gjatë vitit **2015** është 114, prej tyre 94 biznese individuale, 17 biznese te tipit SHPK dhe Kooperativa bujqësore 3. Këto të dhëna janë nxjerrur nga formularët te paraqitura me rastin e regjistrimit te bizneseve nga qytetaret.

- Mirëpo, vetëm fabrika KIVO, veçmas kësaj, numëron afërsisht 70 te punësuar.

Raporti i Inspektorit të Tregut:

Raporti lidhur me lojërat e fatit

- Lidhur me Lojërat e Fatit , Inspektorët Komunal kanë asistuar Inspektorët e ATK-së Divizioni për Lojëra të fatit çdoherë kur është paraqitur nevoja.
- Kemi bërë 3 shkresa zyrtare ku kemi kërkuar intervenim nga Inspektorët e ATK-së .
- Pas kërkesave dhe presioneve të shumta janë organizuar 3 aksione ku janë mbyllur të gjitha subjektet e lojërave të fatit të cilat kanë qenë duke veprua në mënyrë ilegale.
- Lidhur me Lotarinë e Kosovës e cila vepron në qytet gjithashtu kemi kërkuar intervenim nga ATK-Divizioni për Lojëra të fatit.

Inspektimi është bërë, Inspektorët e ATK-së kanë marr të gjitha informatat e nevojshme si dhe dokumentacionin por nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë subjekt.

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

